



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:049886
Datë: 11.03.2025
Numri i dokumentit: 06972006

CA.nr.9049/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Adnan Konushevc - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F. Z. nga P., të cilin e përfaqëson Fehmi Shala avokat nga Prishtina, me autorizim, kundër të paditurës Komuna e Podujevës, të cilën e përfaqëson Faik Rama, jurist i diplomuar me autorizim, Objekt shqyrtimi, kompensimi i paluajtshmerisë, duke vendosur sipas ankesës të parashtruar nga paditësi, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Dega në Podujevë Departamenti i Përgjithshëm C.nr.823/20 të datës 04.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 11.03.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit F. Z. nga Podujeva, **PRISHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Dega në Podujevë Departamenti i Përgjithshëm C.nr.823/20 i datës 04.06.2024 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar C.nr.823/20, të datës 04.06.2024, ka vendosur në këtë mënyrë: **I. REFUZHET padia dhe** kërkesëpafia e paditësit F.Z. nga Podujeva si e pa bazuar, me të cilën ka kërkuar që të **APROVOHET** kërkesëpafia e paditësit F. Z. nga P. dhe të **DETYROHET** e paditura Komuna e Podujevës që ne emër te kompensimit te tokës se marre me Aktvendimin e Sekretariatit për Ekonomi te Komunës se Podujevës nr. 05-465-352 te datës 18 shkurt 1975, e cila evidentohet si Ngastra Kadastrale nr. 215 (P-71712062-00215-0) ZK. Podujeve, për sipërfaqen prej 510 m katrore, shumen prej 229.500.00 euro, duke Llogaritur kumatën ligjore prej 8% nga data 29.02.2024, e deri në pagesën definitive, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm si dhe e paditura t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore ne shumen e përgjithshme prej **10.412.50 euro**. **II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij Aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes

faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet Aktgjykimi i atakuar duke refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.

E paditura nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditësit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, kundër të paditurës, ka parashtruar padi, për shkak të lirit të pronës ose kompensimin e saj të saj, ndërsa në seancën kryesore të datës 14.05.2024 ka mbetur vetëm pranë kërkesës për kompensimin e pronës në shumën prej 229,500.00 Euro si dhe shpenzimet e procedurës.

Duke vepruar sipas padisë së paditësve, gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancave gjyqësore, administrimit të provave ka nxjerrë Aktgjykimin e atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, mes tjerash, theksoi se

Nuk është kontestuese fakti se tani të ndjerit Hajdin Citaku ish nga Podujeva i është marrë paluajtshmëria me aktvendim mbi marrjen nga posedimi privat të tokës së nacionalizuar ndërtimore në regjionin e ngushtë të Podujevës i lëshuar nga Kuvendi Komunal-Sekretariati për ekonomi nr.05-465-352 dt. 18.02.1975, i bazuar në vendimin e ish Rrethit të Prishtinës mbi caktimin e regjionit ngushtë ndërtimore në hapësirën e Podujevës nr.4355/59 d.l. 13.04.1959 e i cili vendim ishte vërtetuar me aktvendimin e Kshillit Ekzekutiv R.S Serbisë numër 590/11 d.l. 16.10.1959 ngastra kadastrale nr.215, me kulturë, pemishte, klasa e 2, në sipërfaqe 00.05.10ha ZK-Podujevë me pronar Hajdin Citaku, sipërfaqja e tërësishme e saj ishte 05.75 ha por 65 ha ishte marrë më parë për ndërtimin e objektit kulturës që këtë rrethanë e pranon dhe motra e paditësit S.Z.Zh . Ajo në procesverbal të gjykatës C.nr.92/09 d.l.03.12.2013 ka deklaruar se ne kemi pasuri 7 ari e 7 metra e për to është bërë pagesa diku në vitin 1969 ku është ndërtuar shtëpia e kulturës.

Nuk është kontestuese se prona kur i është ekspropriua ka qenë në emër të ndjerit Hajdin Citaku 1975 kjo rrethen vërtetohet pa dyshim nga përgjigjeje në padi e të paditurës d.l. 15.05.2013, procesverbal i d.l. 18.02.1975 ku deklaroi se pronën e ka blerë prej X. Z. Podujevë, deklaroi në padi paditësit dhe në seanca i autorizuar i tij, Aktvendimi i Kuvendit Komunal Podujevë Sekretariati për Ekonomi nr.05-465-352 dt. 18.02.1975 mbi marrjen nga posedimi tokën e nacionalizuar në Podujevë nga pronari Hajdin Citaku ngastra nr.215 në sipërfaqe prej 0.05.10 ha ZK-Podujevë, Aktvendimi i trashëgimiti GJ.K. Podujevë T.nr.144/84 dt. 12.11.1984, Kopja e Planit Drejtoris Kadastër, Gjeodozi dhe Pronë Podujevë, fleta poseduese 585 dt. 13.02.1975, ekspertiza ekspertëve gjeodezisë Fahri Ademi C.nr.311/06 dt.28.06.2007, fleta poseduese ZK Podujevë si dhe provat tjera.

Është jokontestuese se pas vdekjes së të ndjerit Hajdin Ali Çitaku Bajçin i lindur 1913 vdekur me 17.07.1984 në shqyrtim trashëgimisë GJK. Podujevë me aktvendimin e saj T.nr. 144/84 dt. 12.11.1984 është shpallur trashëgimtar i vetëm djali i tij Ali Hajdin Çitaku.

Është kontestuese për gjykatën se trashëgimtari i të ndjerit Hajdin Çitaku, Ali Çitaku me kontratën e dt. 22.11.1984 mbi dhënjën në shfrytëzim të pasurisë të paluajtshme si dhënës në shfrytëzim i ka dhënë nipit të tij F. Z. nga ... si marrës në shfrytëzim përhershëm paluajtshmërisë.

Është jokontestuese se kjo kontratë dt.22.11.1984 është vërtetuar në GHK-Podujevë VR.nr.1143/84 dt.04.12.1984.

Është jokontestuese se tani kjo ngastër 215 fleta poseduese 1370 ZK-Podujevë me sipërfaqe prej 0.05.75 ha është evidentuar në emër të paditësit F. Z. provë e saj janë dëshmitë e palëve, në seanca, padi, fleta poseduese nr.1370 ZK-Podujevë dt. 17.07.2006, 08-04-1023, kopja e planit Lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit Gjeodosisë dhe Pronës Podujevë dt. 18.07.2006, kopja e planit dt.28.06.2007, fleta poseduese dt.28.06.2007,ekspertiza e ekspertit GjeodosisëFahri Ademi si dhe provat tjera që gjinden në shkresat e lëndës.

Është jokontestues fakti se Hajdin Citaku dja i paditësit dhe miku i Xh. Z. ka deklaruar se sipas vendimit nr. 01-3/70 te dt. 31 korrik iu ka marre prej shfrytëzimit pllaci me një sipërfaqe prej 0.07.07 ha i cili gjindet ne ish rrugën APJ dhe me vendimin nr. 04-321 prej dt. 27 gusht 1968 iu ka eksproprijua ndërtesa për banim, një shupe e cila ka shërbyer per ti lenë drutë, një shupe per inventarë, një ahër - shtalle, dy pusa, nje Vc dhe gardhi prej gjatësie përtej 50-70 m i përberë prej tarabave dhe ka kërkuar ti kompensohet Xh. Z. dhe iu kane marre prej shfrytëzimit dhe pllaci prej 0.07.07 ha i cili gjindet ne qendre te Podujevës dhe ka shërbyer për lpkale dhe ne plac kane qene dy baraka prej te cilave ka marre qera mujore, ndërtesa e cila ka qene materialit te forte me 3 dhoma dhe korifdor, 2 shgupa, nje shtale , dy pusa dhe 79 trungje pemësh te llojllojshme dhe ka kërkuar çmimin prej 145500 din. te atëhershëm Jugosllav, ne emër te Xh.H.C. si përfaqësues i tij. Ky fakt vërtetohet nga procesverbali mbi shqyrtimin gojor i dt. 30 gusht 1968 dhe ky pllac iu ka nacionalizua dhe marre Xh. Z. prej shfrytëzimi me vendimin nr. 01-3/70 dhe ju ka eksproprijua ndërtesa e cila ka qene ne placin e nacionalizuar, për ndërtimin e shtëpisë se Kulturës. Pale kane qene H. C. si përfaqësues i Xh. Z. babai i paditësit, B.C.si dhe nga organi komunal ref. për çështje pronësorë – juridike R. G. dhe procesmbajtës Sh. L.

Po ashtu shikuar kërkesën e drejtuar organit kompetent nga Xh.Z. nr.014/863 te dates 17 shkurt 1968 vërtetohet se Xh.Z.paraqitet si pronar i keture pronave dhe ka kërkuar qe ti jepet një banese për banim te familjes te cilin organi komunal e ka ne rrugën JNA ne Podujeve.

Sipas vendimit nr. 01-3/151 te dt.28.11.1967 vërtetohet se Xh. Z. ju ka marre dhe është liruar – marre ,nga posedimi privat i paluajtshmerise ne ngastrën kad. nr .21`3, me sipërfaqe prej 0.03.60 ha për universitetin Popullor ne Podujeve Lista poseduese nr. 164.

Ndërsa me aktvendimin- vendimin nr. 04-321 te dt. 27 gusht 1968 i është eksproprijuar Xh. Z. ndërtesa e banimit dhe objektet përcjellëse ne interes te Paaltit- shtëpisë se Kulture ne Podujeve.

Po ti referohemi procesverbalit për n dëgjim te ne seance jashtë seance gojore te përpiluar me dt. 18.02.1975 ne zyrat e k. Podujeve ku si pale paraqitet Hajdin Citaku dhe personi Zyrtar V. Z. nder te tjera thuhet se parcelën e cekur e kam blere me marrëveshje gojore prej Z. Z. dhe me vone sikur i ka rene pishman dhe ate kontrate gojore e kam lënë jashtë fuqie dhe e njëjta nuk ka qene ne pronesi timen dhe kadastrin e ka vene ne emër tim. Andsaj për këtë thuhet drejttohuni Xh.Z. dhe me te udhëhiqen procedurën e nëse është e nevojshme unë do t'ia jap

autorizimin çka mendoj se nuk është e nevojshme. Sa me përket mua unë nuk e kundërshtoj që kjo ngastër të eksproprijohet.

Kontestuese mes palëve dhe për gjykatën ishte rrethana se si ka mundur të bartet prona e eksproprijuar nga i ndjeri Hajdin A. Çitaku në trashëgimtarin Ali H. Çitaku me aktvendimin e trashëgimish GJKP T.nr.144/84 dt. 12.11.1984 dhe si ka mundur të hyj dhe pranohet si masë trashëgimore gjatë shqyrtimit të trashëgimi ndjerit Hajdin dhe të bartet tek trashëgimtari Ali H.Çitaku. Po ashtu kontestuese është fakti si ka mundur të bartet me kontrate mbi dhënien në shfrytëzim nga A. Ç. tek paditësi F.Z. ku paluajtshmëria në fjalë ka qenë eksproprijuar (nacionalizuar) me aktvendim Nr.05-465-352 dt. 18.02.1975 e që për këtë kanë pasur në dijeni edhe palët ndërgjyqëse dhe i ndjeri H. Ç. dhe me pare ishte në emër të Xh. Z.dhe këtë fakt e pranon vetë H. C. dhe atë në vitin 1968, ndërsa tani procedura e kontratës mbi dhuratën dhe ajo mbi shqyrtimin e trashëgimisë e bartja në emër të paditësit kanë ndodhur me vone në periudhe me tepër se 15 vjeçare.

A është bërë në mënyrë ligjore ky shqyrtim trashëgimor dhe pastaj bartja e paluajtshmërive në kontratë mbi shfrytëzim nga A.Ç. të F. Z..

Kontestuese mbeti fakti gjatë shqyrtimit se ka pasur mbështetje ligjore vendimi i marrë nga e paditura Nr.05-465-352 dt. 18.02.1975 për marrje nga posedimi i paluajtshëm së ndjerit Hajdin Çitaku si pronar i tokës ndërtimore nga ana e paditurës.

Kontestuese fakti se a ka pasur bisedime me të paditurën për kompensime nga ana e paditurës Siq ka deklaruar motra e paditësit S. Zh.-Z.me zyrtarët E.S. dhe M. G. se gjaja i kanë deklarua asaj se përpos kompensimit të shumës i takon dhe një lokal dhe banesë.

Gjykata për ti vërtetuar këto fakte në procedurën e provave përpos administrimit të provave bëri dëgjimin e dëshmitareve S.Z.-Z., B. Q., M. G., Av.H. P. si dhe nxori ekspertizën e gjeodezisë F.A. &.28.06.2007.

Dëshmia e dëshmitareve S. Zh.-Z. është kundërthënëse në mes veti në dy seancat e dhëna nga ajo me dt.21.09.2007 C.nr.311/06 dhe dt.03.12.2013 C.nr.92/09, dëshmia në seancën e dt.21.09.2007 ka deklaruar se kjo pronë juridikisht ka qenë në pasuri të vëllaut të nënës (dajës së saj) H. C.faktikisht ajo ka qenë në pronë të babit të saj Xh. Z. të ndjerë, se shtëpinë e ka pasur në ngastrën tjetër por në megjën me ngastrën nr.215 si pjesë e ngastrës.

Se prona nuk është regjistruar në emër të babit sepse ai ka pasur problem me F.P.i cili ka dashtë me ndërtu në tokën tonë akoma pa u bërë e Komunës dhe për këtë i ka mbajtur 40 ditë burg ai. Se për këtë kom shkuar deri në Gjykatën Supreme të Kosovës por dokumentet më janë djeg në luftë. Se ka pasur bisedime me E.S. dhe M.G. për kompensimin e ngastrës së nacionalizuar dhe gjoja i kanë dëshmuar se përpos pagesës në të holla i takon lokal dhe banesë.

Kurse dëshmitarja në seancën &.03.12.2013 C.nr.92/09 la deklaruar se për 7 ari e 7 metra na është bërë pagesa ku dhe është ndërtuar shtëpia e kulturës dhe pagesa është bërë në vitin 1969. Për pjesën tjetër që ka qenë në emër të dajës H. C. se ai ka deklaruar se nuk është e imja pasi që nuk ka mund me pague dhe ajo ka qenë e jona e për këtë është kryer dhe trashëgimia. E din rastin kur komuna ka ndërtuar lokale dhe i ka lëshuar me qira e një prej tyre ka dashtë ta marrë F. P. e babi im ka kundërshtuar dhe ka shkuar në burg.

Sipas saj Gjykata Supreme ka vendos duke obliguar komunën që të paguaj kompensimin por ajo nuk e ka bërë atë. Ka pasur biseda me ish Kryetarin e Komunës E.S. kurse ajo ka qenë sekretare e tij në Komunë. Se a është kontaktuar babai i juaj për pronën e marrë është përgjigj se nuk më kujtohet se ka qenë e re.

Në pyetjen e të autorizuarit të paditurës se kur ka punuar në atë kohë daja juaj H. Q. përgjigjet se ka punuar në Gjykatën Komunale Podujevë si daktilografist.

Gjykata kësaj dëshmie të dëshmitares nuk i fali fare besimin sepse është e njëanshëm e subjektive pasi që ajo është motra e paditësit. Por kuptoj nga krejt kjo se vërtet i është bërë pagesa se ka pasur procedur në Gjykatën Supreme të Kosovës por ju kanë djegur dokumentet e që gjykata nuk e besoi fare është zhdukur dhe lënda e dorëzuar në Gjykatën Komunale Podujevë R ose (Ndryshme) nr. 161/85 e cila edhe përkundër interesimit të gjykatës nuk është në arkivën e saj. Është kërkuar edhe në Gjykatën e Kurshumlisë por prap nuk është gjetur fare. Kjo dëshmi është kundërtënëse në mes veti përpos deklaramit kur thotë se ne kemi pasur shtëpin që ka qenë në ngastrën tjetër por në megj me ngastrën 215 që jep me kuptuar se kjo ngastër nuk ka qenë e tyre kur është eksproprijuar por dajës tyre Hajdinçitaku dhe nuk ka guxuar në asnjë mënyrë të hyj në masën trashëgimore kur është shqyrtuar trashëgimia në këtë gjykatë e ndjerit si pronar Hajdin Citakun.

Dëshmitari tjetër Mehmet Gashi drejtor i Drejtoris për Urbanizëm Komuna Podujevë i cili në deklaramin e tij në seancën e &.03.12.2013 ka cekur se në vitin 31.10.1984 është zgjedhur sekretar i sekretariatit për Ekonomi dhe Urbanizëm dhe nuk ka fare dijeni për këtë rast po mund të ketë ditur drejtori i drejtoris pronësoro juridike dhe ai i administratës dhe aty është zgjedhur. Me këtë deklaram dëshmitari në fjalë i hedh poshtë deklaramet e dëshmitares S.Zh. Z.e Cila në seancën e dt.21.09.2007 C.nr.311/06 kishte deklaruar se kishte bisedua me M. G. për kompensim.

Kjo dëshmi më së miri pasqyron deklaramin e saj si jo objektiv, njëanshme dhe subjektive e që gjykata nuk mundi ti fal besimin.

Edhe dëshmia e dëshmitarit B. Ç.djali H. Ç. asgjë e re nuk tregohet me të se i njëjti thotë nuk din a i është kompensuar babit tij paluajtshmëria. Se ngastra faktikisht ka qenë e Xh. Z.babi i paditësit dhe për këtë arsye vëllau A.ka lidhur kontratë me F. për dhënje në shfrytëzim. Kjo dëshmi për gjykatën është subjektive dhe gjykata nuk i fal fare besimin si të tillë kur ti shtohet se ai është daja i paditësit.

Dëshmitari tjetër H.P. avokat nga Podujeva nuk u deklaroi sepse i i njëjti theksoi se nuk ka dijeni për të dhe është konflikt interesi sepse i padituri me vëlla dhe autorizuari i tyre më kanë lutur që të jem avokat në këtë çështje kontestuese.

Nga ekspertiza e ekspertit të gjeodozis Komuna Podujevës F. A. gjykata vërtetoi se prona nr.215 me sipërfaqe 0.05.75ha fleta poseduese nr.1370 pronar F.Z. dhe kufizohet me parcelën ish ndërtesa gjykatës në verilindje në ... në jug kufizohet me ngastrën 214,216 dhe perëndim ngastra 213.

Ngastra 215 ka qenë e H. A. .Ç por me vendim mbi eksproprijim 05-465-352 dt. 18.02.1975 dhe është pronë e Komunës. Ky aktvendim është i plotfuqishëm me dt. 10.04.1975 sipas ekspertëve për shkaqe për të panjohura kjo prona akoma evidentohet si pronë private por tani në emër të F,,.

Diferenca e paraqitur në vendin prej 0.00.65 ha kjo sipërfaqe është marrë më herët për ndërtimin e ish shtëpisë së kulturës d.m.th para vitit 1975 dhe tani ka sipërfaqe prej 0.05.10 ha.

Eksperti Fahri Ademi është dëgjuar përsëri ne rigjykim C. nr.823/20 ne seancën e dt.21.04.2021. Eksperti ka deklarua se mbetet ne tersi pranë ekspertizës se mëhershme pa asnjë ndryshim ne te., ku deklaroi se te gjitha te dhënat e paraqitura ne ekspertizë i ka mbështetur ne nga te dhënat ne shkresat e lendes dhe te dhënat ne kadastër përfshire këtu dhe se kjo ngastër ka

rene ne zonën e ngushte te qytetit dhe ne baze te nje vendimi nr, 44355/59 te dt. 13.04.1959 mbi zonat e nacionalizuara është marre vendimi qe kjo ngastër te nacionalizohet dhe jam i sigurt se e kam pare ketë dokument, kjo nga eksperti. Sa i per ketë sipërfaqes se kërkuar nga pala paditëse te përcaktohet per sipërfaqen prej 65 m katrore, deklaroi se me asnjë vendim te caktuar nuk kemi nga kadastra te jete ndare nga pjesa e tjetër e ngastrës prej 510 m duke u përgjigjur ne pyetjen e autorizuarit te paditësit. Andaj pa ndonjë vendim te gjykatës apo noterit, apo komunës ne nuk mund ta ndajmë parcelën për ketë sipërfaqe prej 65 m katrore. Asnjëherë nuk është bere ndarja siç pretendon pala paditëse dhe kjo ngastër edhe sot e ka sipërfaqen prej 575 m katrore. Për mua është absurde qe jane marre paret per marre te hollat per 510 m katore e jo dhe për 65 m katrore, te bëra sipas eksproprijimit. Kjo pjese e ngastres kad, prej 65 m katore e pretenduar nga pala paditëse gjendet ne pjesën jugore te parcelës nr. 213 dhe çdo ndarje e pjesës se saj duhet te behet sipas kërkesës se palës se interesuar per ndryshime Ky shshesh është i ndërtuar nga vitit 1977 dhe kam përvoje 40 vjeçare ne Komune.

Pasi qe pala paditëse kishte vërejtje ne ekspertize ka caktuar ekspertizën me ekspert tjetër te gjeodezisë Muzafer Mustafa nga Prishtina i cili ka përgatitur përmes punimit me shkrim ekspertizën e dt. 31.05.2023 i cili ka theksuar se: Sikur ne gjithë Kosovën edhe ne Podujeve, ne fillim është punuar kadastrri përshkrues, i cili ka qene kadastër i përafërt dhe është shfrytëzuar për punën e tatimeve.

Plani kadastral qe përfshinë ketë pjese, ku gjendet parcela nr. 215-0 është plani 7G17-hd-1, fleta detale 12, i cili plan është punuar fillimisht me matje Ortogonale ne vitin 1959, pastaj plani është përshkruar (plotësuar) me matjet e vitit 1979, ku ne fund është reprodukuar-riprodhuar ne vitin 1981.

Parcela nr. 215-0 tani shtrihet ne pjesën e sheshit Qendror te Qytetit te Podujeves, Sheshi “Ali Ajeti” , ne afërsi te objektit te vjetër te Komunës se Podujevës dhe objektit te ri te Komunës si dhe ne afërsi te Gjykatës se Podujevës.

Parcela nr. 215-0 ne pjesen veriore kufizohet me parcelën nr. 209-0, ish objekti i Gjykates ne Podujeve, ne pjesen perendimore kufizohet me parcelen nr. 213-0 ku ka qene objekti i vjeter i shtepise se Kulturexzs ne Podujeve, ne pjesn jugore kufizohet me parcelen nr. 214-0 dhe ne lindje me kufizohet me ngastrën 216-0 dhe 2017-0 re cila eshte rruge.

Parcela nr. 215-0 ZK. Podujeve ne baze te vektorit aktual ka sipërfaqe prej 542 m katpore, e cila ka nje mospërputhje, pasi qe ne certifikatën e pronës per parcelën ne fjale është sipërfaqja prej 575 m katrore dhe duke u bazuar ne kornizat e punes 2020/01, kjo është jashtë tolerancës, pasi qe toleranca e lejuar për 575 m katrore është + dhe- 9.59 m katore, kurse dallimi është 33m katrore. Nga kjo detyrohemi te bëjmë analizën e planit kadastral se ku mund te jete gabimi i mundur.

Bazuar ne gjendjen aktuale te vektorit nga Gjeoportali Shtetror i Kosovës sipërfaqja e parcelës nr. 215-00 është prej 542 m katore dhe se vektori i parcelës 215-0 nuk i përgjigjet parcelës baze te vjetër edhe ate ne pjesën perëndimore. Dallimi është ne pjesën perëndimore, aty ku ka qene i ndertuar objekti i Shtëpisë se Kulutres Kkrejt ne baze te kësaj për mua është e paqarte pse ne FP nuk ka ndryshim te sipërfaqes, kurse ne pjesën vektoriale ka ndryshim dhe se sipërfaqja nuk ka përputhshmëri.

Kjo pjese e sipërfaqes se ngastrës kad. nr. 215-0 sipas aktvendimit nr. 01-3/151 te dt. 28.11.1967 përkufizohet përmes pikave detale 4-5-6-12, e cila ne baze te vektorizimit te kësaj sipërfaqeje ka sipërfaqe prej 45 m katrore, Kjo pjese ne tri (3) ane kufizohet me parcelën nr.

215-0 dhe atë ne veri, përmes pikave 4 deri te pika 5, ne distance prej 3.71 m, ne lindje ne mes te pikave 5 dhe 6 ne distance prej 8.43 m ne jug ne mes pikave 6 dhe 12, ne distance prej 6.83 m dhe ne perëndim kufizohet me parcelën nr, 213-0, edhe ate përmes pikave 12 dhe 4 ne distance prtej 9.25 m, kjo pjese sipas simbolit te planit kadastral është objekt.

Pjesa tjetër e mbetur e parcelës nr. 215-0 përshkruhet nëpërmes pikave 1-2-3-4-5-6-12-8-9-10-11, e cila ka sipërfaqe prej 530 m katrore dhe e prezantuar ne skice me dimensione (skica5)

Pas kësaj pala paditëse ka kërkuar sqarime shtese dhe te ftohet eksperti ne seance dhe ka prezantuar ne seancën e dt.20.09.2023 i cili ka deklaruar se mbetet ne tersi pranë ekspertizës se dorëzuar me shkrim ne gjykatësi cili duke u përgjigjur ne pyetjen e te autorizuarit te paditësit ka deklaruar se; duke krahasuar gjendjen aktuale ne gjë portal shtetëror kam vërejtur nje ndryshim ne sipërfaqe te ngastrës nr. 215-0 ZK. Podujeve, i cili ndryshim mendoj se është pasi qe vendimi nr. 01-3/150 i dt. 28.11.1967 (duhet te jete 151) nuk është zbatuar ne pjesën tekstuale por vetëm është vizatuar ne plane., qe do te thotë se sipërfaqja prej 65 m katrorë ne baze te vendimit te lartcekur nuk i është hequr parcelës nr., 215-0 nga FP, i cili vendim është marre bazuar ne dokumentacionin për ndërtimin e shtëpisë se kulturës ne Podujeve. Fjala vektor d.m.th. digjitalizim te nje harte analoge te përgatitur digjitale.. Me një fjalë vi e paraqitur e prezantuar ne mes dy koordinatave ne sistem shtetëror.

Eksperti ka bere dhe një plotësim ekspertize me dt. 09.11.2023. Per te vërtetuar vlerën e paluajtshme risë pjese e ngastrës kad. nr. 215-00 ne sipërfaqe prej 65 m katrore e te cilen pala paditëse pretendona se nuk i është kompania palës paditëse gjykata ka nxjerre provën me ekspertin e vlerësimit te paluajtshme rivë Lulzim Dema nga Prishtin e i cili ka hartuar dhe paraqitur me shkrim gjykatës ekspertizën me dt.29.02.2024. i cili ne mendimin e tij përfundimtar ka vlerësuar vlerën e saj prej 229.500 euro, te cilen edhe pala paditëse e ka precizuar padinë dhe kërkesëpadinë ne pajtim me ketë ekspertize.

Nga parashtesa e dorëzuar nëpërmes postës rekomande dt. 12.04.1985 propozimi për ekzekutim për kompenzim tokës ndërtimore të pa paguar në Gjykatën Komunale Podujevë në sipërfaqe prej 0.05.10ha ka marrë numrin në gjykatë Nrdyshme (R) m. 161/85 të cilës i kan humbur gjurmët dhe nuk gjendet askund. Ka kërkuar shumën për kompenzim propozuesi F,Z, prej 1 1.000.000.00 dinarë me kamatë prej 15%.

Nga deklarat e vërtetuar te noteri S,V, ,, të dhënë nga A, 1-1.Ç, dt. 18.08.2013 gjykata vërteton se ka deklaruar se prona faktikisht nuk ka qen e tyre për këtë arsye e ka bartë te djali i hallës F, Z,.

Nga vendimi për vërtetim të interesit të përgjithshëm për ndërtim të ndërtesave të banimit dhe qendrës punuese(tregtare) në pronën e nacionalizuar të tokës ndërtimore në Podujevë nga Kuvendi Komunal Podujevë nr.01-4/6 dt.27.02.1965 janë eksproprijuar ngastrat nr.37/4 fleta poseduese 184 ZK-Podujevë sipërfaqe prej 0.07.20ha pronar PeçaraninNikolaVuksan dhe ngastra 37/3-1 fleta poseduese 68 ZK-Podujevë, sipërfaqe prej 0.05.35ha pronar DjurkoviqLeposave që i kanë shfrytzu në atë moment Xh, Z,, U,H, dhe F,H, janë ekspropriju dhe janë në megje me ngastrën e H.Ç.e të cilat janë kompenzuar.

Nga arsyetimi i vendimit konstatohet se mjetet janë të siguruara për kompensim dhe nuk ka pasur asnjë arsye të mos jen siguruar mjetet për pagesën edhe të paluajtshmërive së paditësit ku prona ka qenë e H. Ç. sepse ish Jugosllavia ka qenë një shtet mjaft mirë i organizuar dhe

serioz në këtë aspekt e nuk i ka mbetur askujt borgj pa ju kompensuar pronat e eksproprijuar. Nga procesverbali i dt. 18.02.1975 në zyrat e Kuvendit Komunal Podujevë ku preznet ishte dhe H.Ç. është njoftuar me propozimin e avokatit publik Komunal për marrjen nga posedimi provat të ngastrës kadastrale 215 ZK-Podujevë sipërfaqe prej 0.05.1 O. H. Ç. ku deklarohet se e ka blerë ngastrën, marrëveshje gojore prej Xh. Z. dhe gjoja ai i ka bërë pishman dhe këtë marrëveshje kemi lënë jasht fuqie, por kadastrit kur e ka matur e ka lënë në emrin tim dhe për këtë bisedoni me të dhe zhvilloni procedurën dhe ai nuk kundërshton që ngastra të eksproprijohet.

Nga kjo gjykata vërtetohet se nuk qëndron konstatimi se prona është e Xh.Z. por e tija dhe në emër të tij. Shtrohet pyetja çfarë interesi dhe nevojë ka pasur atëherë A.H. Ç. të lidhë kontratë mbi shfrytëzimin me paditurin F. Z. për paluajtshmërit nëse ato kanë qenë të Xh. Z. nuk ka pasur nevojë fare me ja bart me kontratë mbi shfrytëzimin nëse ato kanë qenë të babit të paditësit. Por këtu shifet se janë bërë ndryshime të qëllimshme dhe me arsye të caktuar kur është bërë shqyrtimi i trashëgimish H.Ç. me aktvendimi GJK-Podujevë T.nr.144/84 dt. 12.11.1984 dhe kontrata dt.04.12.1984 që në asnjë mënyrë nuk është dashur dhe është bërë pa bazë ligjore hyrja e ngastrës kadastrale 215 në masën trashëgimore dhe është shpallur trashëgimtar i vetëm A.Ç., kjo nuk ka guxuar të ndodhë në asnjë mënyrë.

Ka qenë pandërgjegjëja dhe jo profesionalizmi i Kadastrit Podujevë nuk ka përcjell gjendjen dhe aktet juridike të marrura nga organi kompetent duke lejuar bartjen e ngastrës 215 nga trashëgimtari A. Ç. i cili pa të drejtë është shpallur nga gjykata trashëgimtar T.nr.144/84 dt. 12.11.1984 bart nga ai tek paditësi dhe të njëjtën e vërtetojnë në Gjykatë me Vr.nr.1145/84 dt.11.12.1984.

Vendimi i Kuvendit Komunal Podujevë-Sekretariatit për Ekonomi nr.05-465-352 dt. 18.02.1975 është i bazuar në nenin 38 par. 1 Ligjit me nacionalizimin e ndërtesave me qera dhe tokës ndërtimore dhe tokës ndërtimore GZ RSFJ nr.52/58 dhe neni 56 ligjit mbi eksproprijimin GZ.KSAK nr.25/73 ku vendimi lidhur me marrjen nga posedimi privat tokën e nacionalizuar në Podujevë nga pronari H.Ç. në posedim të Komunës së Podujevës.

Kurse vendimi me nr.4355/59 dt. 13.04.1959 është si vendim i Rrethit të Prishtinës mbi caktimin e regjionit të ngushtë ndërtimor në territorin e Podujevës se në cilën bazë është miratuar. Kjo gjykata edhe përkundër asaj që ka kërkuar prej të paditurit ta siguroj atë e njëjta nuk ka mund ta siguroj edhe pse ka bërë përpjekje të mëdha ta bëjë këtë bile edhe në arkivën e Prishtinës.

Paditësi së pari është dashur të kërkoj nga e paditura Komuna e Podujevës që të zbatoj rekomandimet dhe vërejtjet Gjykata Kushtetuese RSFJ dhe ta anuloj vendimin e saj e jo të marrë veprime të njëanshme të kryej trashëgimin duke përfshirë në masë trashëgimore ngastrën kadastrale e pastaj me kontratë ta bart trashëgimtari H.Ç. në paditësin F. Z. në mënyrë joligjore.

Ne rast se ka të drejtë pala paditëse atëherë do të ishte e udhës dhe e drejtë që Parlamenti i R. Kosovës të nxjerr ligjin mbi kthimin e tokave të nacionalizuara për ish pronaret dhe atëherë do të fitonte të drejtën e tij paditësi të kërkoj kompensimin e vlerës së paluajtshmerisë së cilës pretendon që i është marre. Anipse me provat e cekrua me lartë vërtetohet se i është marre në tersi paluajtshmeria, ndërsa ekspertet nuk ishin të sigurt se a ka mbetur pjesë e saj pa u nacionalizuar dhe eksproprijuar. Andaj dhe gjykata iu dha pjesërisht besimin ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë M. M., ndërsa ia dha atë plotësisht ekspertit tjetër të gjeodezisë Fahri Ademi i cili ka një përvojë të gjatë në institucionin e kadastrit në Podujevë dhe ka njohuri lidhur me atë se

çka dhe si është eksproprijuar paluajtshme ia dhe e ka potencuar atë ne ekspertizë dhe plotësimin e saj te bere ne seance.

Po ashtu sa i përket vendimit te Gjykates Kushtetuese te ish Jugosllavise se gjoja ka shpallur nul vendimet e organeve Republikane kjo nuk mund te vërtetohet ngase aty janë marre edhe toka tjera nga e paditura siq jane ngastra nr. 209, 2013, 214, 216 etj ku janë kaluar ne prone publike te Komunes se Podujeves dhe janë kompensuar dhe nuk ka pasur asnje reagim apo kundershtrim nga palet tjera e pse do te ishte përjashtimi ne rastin konkret tek paditësi, kjo për faktin se edhe familja e tij dhe vet paditësi jane kompenzuar por e shfrytëzojnë situatën e mungesës se dokumentacionit ne Drejtorin e Kadastrit dhe arsyet tjera te cekura nga gjykata me larte.

Shtrohet pyetja kur ishte gjerë në atë kohë prej viteve 1975 paditësi që nuk kërkoj të bëhet anulimi i vendimeve nëse ka menduar se ka pasur të drejtë por të pres gjerë në përfundim të luftës vitet 2006 më tepër se 30 vite. Nga këtu veprimet e tij nuk kanë qenë të bazuara në ligj dhe ka humbur të drejtën e tij me kërkukompenzim për pronën kontestuese. Prandaj dispozitat e neneve 34 dhe 35 Ligjit mbi nacionalizimin nuk janë anuluar gjerë më sot me asnjë vendim tjetër dhe nuk është kërkuar nga pala paditëse që të anulohet vendimi mbi marrjen nga posedimi i paluajtshmërive atëherë gjykata vendosi që ta refuzoj si të pabazuar padin dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe vendimi mbi nacionalizimin e paluajtshmëris së H.Ç. është i bazuar në ligj dhe veprimet e marra nga trashëgimlënësi A. Ç. djali i H. Ç. nuk kanë guxuar të merren as të pranohen si të ligjshme ku është marrë dhe pranuar edhe nga ana e Gjykatës në masën trashëgimore të trashëgimlënësit H. Ç., gjithashtu as kontrata mbi dhënjën në shfrytëzim të paluajtshmërive në të A.Ç. dhe paditesit F. Z. nuk janë të rregullta dhe toka ka qenë e nacionalizuar, kompensuar dhe si e tillë është pronë publike e të paditurës Komuna Podujevës. Nuk ka bazë për kompensimin e paluajtshmërive me provë tjetër apo kundërvlera e saj në të holla sipas çmimeve të tregut kohën kur është nacionalizuar toka sepse edhe ngastrat tjera kanë qenë në atë kohë të nacionalizuara dhe kanë mbetur në pronësi të paditurës dhe nuk janë anuluar vendimet. Të gjitha janë kompensuar dhe nuk janë kontestuar nga asnjë ish pronar gjerë më tani. Duke iu referuar ligjit mbi nacionalizimin e objekteve me qira dhe tokës ndërtimore nr.52/58 Gazeta Zyrtare e RSFJ, nacionalizimin e paluajtshmëris së H. Ç. e ka kryer organi kompetent i caktuar me këtë ligj Komuna e Podujevës. Duke iu referuar nenit 9 të ligjit pronar i paluajtshmëris në momentin e nacionalizimit të paluajtshmëm me këtë ligj është ai që është në ditën e hyrjes në fuqitë këtij ligji që në këtë rast në momentin e nacionalizimi të palujtshmëris ka qenë si pronar H. Ç. e askush tjetër dhe të parëndësishme janë veprimet e mëvonshme të kryera nga trashëgimtari i tij A.Ç. dhe paditësi F. Z.

Duke ju referuar nenit 60 të ligjit, pronarit që ju ka marrë toka ndërtimore në posedim nuk ka pasur drejtë ankese dhe hyrjen e konfliktit administrativ duke u bazuar në nenet 58 ku është nacionalizuar toka ndërtimore nga organi komunal për punë financiare kundër vendimit për kompensim nuk lejohet ankesa as konflikti administrativ sepse veç ju ka nacionalizuar paluajtshmëria dhe ju ka caktuar shuma për kompensim. Pala ish pronari i paluajtshmërive ka pasur të drejtë prej 30 ditësh me kërkuar që gjykata ta vërtetoj, caktoj shumën e kompensimit por ish pronari H. Ç. këtë nuk e ka bërë. Paditësi ka kërkuar tek në vitin 1985 kompensimin në procedurë jasht kontestimore e nuk dihet çka është bërë me atë lëndë dhe ka humbur pa gjurmë nga Gjykata. Atëherë kundër vendimit të gjykatës do kishte pasur drejtë ankese ish pronari në

afat prej 15 ditësh. Sipas nenit 61 kompetent për caktimin e shumës së kompensimit është Komuna.

Poashtu kërkesa e paditesit është edhe e parashkruar konform ligjit mbi ekspirorprrijimin viti 1978 neni 21 par.3, 4 dhe 5 ,LPB neni 268 numer ligji 527 i vitit 1976. Ligji mbi qarkullimin e paluajtshmerive i KSAK G.Z. num,er 45/80, 29/86, 28/88. Andaj nisur nga këto fakte të vërtetuara në procedurë gjykata gjeti se nuk është e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe si të tillë e refuzoj siç është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi lidhur me shpenzimet u mor konform nenit 452.1 të LPK-së.

Pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit nuk mund t'i pranojë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore nga pika 182.2, pika (n) i LPK-së, meqë ka të meta që nuk mund të ekzaminohen, dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit nuk janë në harmoninë e duhur logjike dhe juridike, ndërsa faktet vendimtare nuk janë vërtetuar dhe arsyetuar si duhet, për çka edhe është bërë dhe vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike dhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Si rrjedhojë, veprimet e gjykatës së shkallës së parë vlerësohen të jenë në kundërshtim me nenin 160.4 të LPK-së që përcakton elementet që duhet t'i përmbajë një arsyetim i një aktgjykimi, si rezultat i së cilave kemi vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të disa prej fakteve bazë që do të ndikonin në nxjerrjen e një vendimi gjyqësor të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në këtë drejtim, rezulton se gjykata e shkallës së parë, përkundër detyrimit ligjor që rrjedh nga neni 160 parag.4 i LPK-së, në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, nuk i trajton të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse, nuk sqaron se me provat e administruara cila është gjendja faktike e vërtetuar, cilave prova i ka falur besimin e cilave jo, cilat kanë qenë faktet vendimtare të cilat i ka marr për bazë me rastin e vendosjes, ashtu siç kërkohet me dispozitën e nenit 8 të LPK-së. Në lidhje me këtë, kjo dispozitë, përkatësisht parag. 1 i saj, shprehimisht përcakton se: “Se cilat fakte do t'i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë te rezultatit të gjithë procedimit”, ndërsa parag.2 i të njëjtës dispozitë, përcakton se: “Gjykata me ndërgjegje dhe me kujdes e çmon ç’do provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku”.

Me rastin e shqyrtimit të aktgjykimit të atakuar, brenda kufijve të pretendimeve ankimore, si dhe sipas detyrës zyrtare (ex officio), në kuptim të nenit 194 të LPK-së, Gjykatës së Apelit i rezulton se dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së parë nuk është formuluar konform nenit 160 të LPK-së, që përcakton strukturën dhe përmbajtjen që duhet ta ketë një vendim gjyqësor për të qenë i drejtë dhe i ligjshëm.

Për shkak të mangësive të evidentuara më lartë, përkatësisht gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar faktet vendimtare tek ky kontest juridik-civil që ka të bëjë me kompensimin e dëmit material, e që i referohen shkeljes së dispozitave të ligjit të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n), lidhur me nenin 160 parag. 3, 4 dhe 5 të LPK-së, konstatimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se nuk janë krijuar kushtet ligjore që të mund të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së

shkallës së parë, por është dashur që të priset aktgjykimi i atakuar dhe lënda të rikthehet në rigjykim dhe rivendsoje.

Pronësia është ndër institutet ma të rëndësishme në të drejtën civile dhe si i tillë gëzon edhe mbrojtje juridike, kjo është e rregulluar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës në nenin 46; Ligjin për Pronësiën dhe të Drejtat Tjera Sendore Nr. 03/L-154, përkatësisht në kapitullin e VII të tij; Konventën Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Protokoll shtojcë i Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore në nenin 1, po ashtu e njejta është garantuar edhe me dispozitat ligjore të kohës kur ka ndodhur veprimi i të paditurës ndaj pronës objekt shqyrtimi (dt.18.02.1975). Megjithatë në praktikë kemi edhe kufizim të ushtrimit të së drejtës së pronësisë, njëra prej tyre është përdorimi i të drejtës deri në atë masë sa tjetrit nuk i shkakton dëm, pra keqpërdorimi i të drejtave është i ndaluar dhe rastin tjetër e kemi kur kufizohet të drejtat e pronësisë për shkak të interesit të përgjithshëm që është rasti konkret por gjithmonë me kompensim adekuat në kohën e kufizimit të të drejtës së pronësisë (*eksproprijimit*). Në rastin konkret kemi kufizim të së drejtave të pronësisë për interes të përgjithshëm publikë për përgaditjen e planit detal urbanistik për ndërtim banesor.

Gjykata e shkallës së parë fillimisht në riprocedurë duhet të vërtetoj bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësit dhe më pastaj lartësinë e saj. Gjykata e shkallës së parë ka dështuar të vërtetoj faktin se e paditura ka zhvilluar procedurën e eksproprijimit sipas Aktvendimit të datës 18.02.1975, ku në dispozitiv të tij theksohet se prona objekt shqyrtimi do të vlerësohet dhe të t'i paguhet pronarit sipas ligjit për eksproprijimit. Pra përveç deposedimit të paditësit dhe paraardhësit të tij H. Q., nuk është vërtetuar se e paditura konform këtij vendimi ka vlerësuar pronën e paditësit dhe të njejtën e ka paguar sipas vlerës së tregut në kohën e ndodhjes së veprimit juridik.

Arsyetimi i gjykatës duhet të jetë konform vendomarrjes së saj, përkatësisht duhet t'i përgjigjet dispozitivit të tij. Mos arsyetimi i një vendimi meritor paraqet shkelje esenciale me rëndësi absolute, me ç'rast vendimi duhet të priset, këtë e parasheh shprehimisht dispozita e nenit 182, par. 2 nënpar. n të LPK. Sipas kësaj dispozite, vendimi përmban një shkelje esenciale të dispozitave procedurale, nëse ai nuk është arsyetuar, ndërsa sipas kësaj gjykate Aktgjykimi i atakuar nuk është arsyetuar mjaftueshëm sa i përket kërkesës për kompesimin të dëmit material dhe për këtë arsye vendimi i paarsyetuar konsiderohet edhe vendimi, i cili është kontradiktor në mes të gjendjes faktike të konstatuar dhe arsyetimit të vendimit. Për më tepër, secila palë ka të drejtë në arsyetimin e vendimit dhe se mos respektimi i kësaj përbën shkelje të nenit 6 të KEMDNJ, e cila Konventë është pjesë përbërëse e të drejtës pozitive të Republikës së Kosovës. Fillimisht duhet të cekën të gjitha faktet e tilla, duhet të paraqiten faktet e prezantuara të palëve, të cilat janë edhe kontestuese nga ana e palëve si dhe faktet jokontestuese sa i përket objektit të shqyrtimit.

Tek rastet e kompensimit të dëmit material siç është rasti konkret duhet të vërtetohet këto fakte më rëndësi: për të ekzistuar dëmi duhet që veprimi apo mos veprimi i të paditurës të jetë rezultat i dëmit të shkaktuar tek paditësi, që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar faktin se prona objekt shqyrtimi është vlerësuar nga e paditura dhe më pastaj i është

paguar pronarit të saj, pra nuk është vërtetuar mjaftueshëm kjo lidhje shkak-pasojë që është vendimtare në rastin konkret. Ai është vendimtar për krijimin e përgjegjësisë juridike civile për dëmin e shkaktuar, sepse rreth tij sillen dhe rezultojnë të gjitha kushtet e tjera që kanë të bëjnë me këtë përgjegjësi. Shkaktimi i dëmit, si fakt juridik, paraqet rrethanë të caktuar e cila sjell deri te krijimi, ndryshimi apo ndërprerja e marrëdhënies së detyrimeve. Një ndër kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, është edhe lidhja kauzale që ekziston midis veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar.

Shtrohet pyetja ka të drejtë shteti t'ia marrë pronën personit fizik apo juridik pa kompensim adekuat? Përgjigjja është **JO**, përveç nëse vërtetohet se e njëjta është përfituar me vepër penale, apo është përdorur për veprimtari kriminale, e cila më pastaj përmes procedurës penale fillimisht sekuestrohet me vendim të formës së prerë konfiskohet.

Pra Gjykata e Apelit vlerëson se për të lindur e drejta e paditësit për të kërkuar kompensimin e dëmit ndaj të paditurës duhet të plotësohet këto kushte ligjore: shkaktimi i dëmit; paligjshmëria e të paditurës; fajësia e të paditurës që ka shkaktuar dëmin dhe lidhja shkakore në mes të veprimit, mosveprimit dhe dëmit të shkaktuar, e cilat fakte me rëndësi gjykata e shkallës së për në riprocedurë duhet t'i vërtetoj.

Nëse vërtetohet se e paditura ka marr pronën pa kompensim adekuat, atëherë veprimet e saj mund të konsiderohet të kundërligjshme, ndërsa kur të njëjtat i paraprijnë një procedurë e rregullt e ekspropriimit dhe me qëllimin e vetëm interesin publik, atëherë nuk mund të flitet për paligjshmëri, por marrje e pronës për interes publik dhe kompensimin e saj adekuat.

Nga gjitha arsyet e cekura si më lartë, Gjykata e Apelit gjeti se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkeljet e sipërcituara të cilat gjykata e shkallës së parë duhet t'i eliminojë në ri procedurë, në atë mënyrë që të ndërmer veprime përmes të cilave do t'i eliminoj shkeljet e cekura si më lartë, por njëkohësisht duke u kujdesur edhe për çështjet e tjera nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor dhe në këtë kuptim duhet të vlerësoj të gjitha prezumimet procedurale që kanë të bëjnë me gjykatën, palët-përfaqësimin, objektin e kontestit dhe rregullsitë formale të padisë dhe të vendos për themelësinë e kërkesëpadisë së paditësve. Me rastin e vendosjes në lidhje me kërkesëpadinë e paditësit, gjykata e shkallës së parë, përveçse ka për detyrim që të vërtetoj drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike në këtë procedurë, ajo duhet të kujdeset për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale.

Andaj, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë të veprojë sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, t'i eliminojë shkeljet e sipër theksuara, në atë mënyrë që fillimisht sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse, gjykata e shkallës së parë të ndërmer hapa të tjetër procedural në drejtim të xjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar drejtë të drejtën materiale, të ketë mundësi të vendos në mënyrë meritore për kërkesat e palëve ndërgjyqëse. Të kërkojë plotësimin e ekspertizës për vlerësimin e pronës, që e njëjta në plotësim të ketë parasysh edhe vlerësimin në kohën e depozedimit të paditësit përmes Aktvendimit të datës 18.02.1975, *(shih Aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev.nr.384/2024 të*

datës 17.09.2024). Të kërkoj nga pala paditëse që të bëjë rregullimin e padisë, përkatësisht petitumit të saj që ka të bëjë me çështjen e kompensimit të pronës (215 me sipërfaqe të tërësishme prej 575 m², ndërsa objekt shqyrtimi është sipërfaqja prej 510 m² ZK Podujevë) me përmasa dhe kufijt, në bazë të ekspertizës gjeodezike, e po ashtu pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse të zbatojë me përpikëri nenin 8, lidhur me nenin 160 paragraf 4 të LPK-së, përkatësisht në arsyetimin e aktgjykimit të jap të gjitha vlerësimet e nevojshme për secilën provë të administruar, cilat fakte vendimtare i ka vërtetuar me provat e administruara dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike, të vendos për kërkesëpadinë e paditësve në bazë të ligjit, përfshirë këtu edhe për shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, dhe 195 paragraf 1 pika (c) e LPK-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.9049/2024, datë 11.03.2025

Kryetari i kolegjit,
Ardian Ajvazi